Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ishte mbivlerësuar për 964,581€ kryesisht si rezultat i mos-bartjes së pronësisë së projekteve të përfunduara tek komunat përkatëse. Ndërsa vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PVF-ve ishte nënvlerësuar për 66,919€ si rezultat i mos regjistrimit të pasurive në sistemin e-pasuria;

C1 Për 20 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur ‘’Mbrojtja civile’’, MKRS-ja në mungesë të dëshmisë për vijueshmërinë në punë, gjatë vitit 2022 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 76,791€ në emër të pagave;

B2 Gjatë vitit 2022 MKRS kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 183,968€ në kategori ekonomike jo adekuate;

A1 Vlera e shpalosur në PFV e detyrimeve kontigjente ishte e mbivlerësuar për 41,016€ ndërsa obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar për 16,226€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin

e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B3 MKRS në fund të vitit 2022 kishte avance të hapura për udhëtime zyrtare në vlerë 47,389€;

B4 Në 11 raste në vlerë 218,452€, kishte mangësi në procedimin e pagesave, pasi që në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja;

B5 Në 19 raste në vlerë prej 1,784,551€ nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet me marrëveshje dhe në dy raste ishin vërejtur dobësi në mbylljen/arsyetimin e subvencioneve;

A2 Tejkalim i vlerës së kontratës kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së" për 16,235€;

B6 Në shtatë mostra në vlerë 78,451€ kishte vonesa në pagesa përtej afatit kohor ligjor prej 30 ditë. Vonesat ishin deri në 3 vite.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

UD Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në vitin 2022, MKRS ka shpenzuar 72% të buxhetit final ose 25,103,235€, me një ulje prej 20% në krahasim me vitin 2021. Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me regjistrin e pasurisë, klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, proceset e prokurimit si vonesa në realizimin e punimeve si dhe tejkalim të kontratës. Mangësi tjera janë edhe procesi i dhënies dhe menaxhimit të subvencioneve, pastaj vonesa në mbyllje të avanceve, vonesa në pagesën e faturave si dhe mbivlerësim i obligimeve të papaguara dhe atyre kontigjente në PFV.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja

Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës. Po ashtu, neni 6.3 potencon ”Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Vlera e pasurive e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV) ishte mbivlerësuar për 964,581€ kryesisht si rezultat i mos-bartjes së pronësisë së projekteve të përfunduara tek komunat përkatëse si dhe nënvlerësuar për 66,919€ si rezultat i mos regjistrimit të pasurive në sistemin e-pasuria. Të paraqitura në detaje si në vijim:

- Në regjistrin kontabël të ministrisë ende figurojnë të regjistruara si investime në vijim projekte për të cilat ishin bërë pranimet teknik[5] që nga viti 2016 e tutje. Mostrat/pagesat e testuara në vlerë 994,306€ ende figurojnë në regjistrat e pasurisë të MKRS duke mbivlerësuar vlerën e pasurive. Bazuar në raportet e pranimit teknik këto projekte do të duhej të largoheshin nga regjistrat e ministrisë dhe të kalonin tek komunat përkatëse.

  MKRS nuk kishte regjistruar në regjistrin e SIMFK pasurinë në vlerën prej 29,725€ duke shkaktuar nënvlerësim të regjistrit dhe;

  Pasuria jo kapitale (nën 1,000€) e prezantuar në PVF ishte nën vlerësuar për 66,919€ për shkak se e njëjta nuk ishte regjistruar në regjistrin e-pasuria.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme, ku në mungesë të përcjelljes së informatave për projektet e përfunduara ato ende kanë statusin si investime në vijim.

Ndikimi

Mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim si dhe mos regjistrimi i të gjithë pasurisë në sistemin e-pasuria pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi mbivlerësim/nënvlerësim të pasurive duke rezultuar në prezantim jo të saktë dhe të plotë të tyre në PFV. Po ashtu, pasuritë e paregjistruara mund ti ekspozohen rrezikut të humbjes dhe tjetërsimit.

Rekomandimi B1

Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike, përmes procedurave formale, të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë t’i

largoj ato nga regjistrat e pasurisë së ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet regjistrimi i pasurive jo-kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve, përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Ministria kishte vazhduar të paguajë zyrtarët bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 06/39 të dt. 22.07.2015, për 20 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrojtja civile" përderisa nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Ministra kishte marrë vendim me datë 19.08.2022 për të pezulluar pagat e këtyre punonjësve deri në gjetjen e një alternative. Vlera e pagesave të realizuara për këta punonjës deri në marrjen e vendimit ishte 76,791€.

Në institucionet vartëse të MKRS, Filharmonia e Kosovës dhe ASHAK/departamenti i arkivave ndërkomunale Mitrovicë, është vërejtur se nuk ka sistem elektronik të vijueshmërisë dhe as listë fizike ku do të nënshkruheshin punonjësit. Përgjegjësinë/dëshminë për vijueshmërinë në punë të punonjësve e kanë konfirmuar me raport/email udhëheqësit përgjegjës.

Ne identifikuam dy raste (njëri në ministri dhe tjetri në Bibliotekën Kombëtare) ku punonjësit kishin marrë pagën e plotë 370€ dhe 480€ për muaj pa dëshmi të vijueshmërisë në punë me arsyetimin për vetëm 4 ditë pune.

Këtë situatë e ka shkaktuar mungesa e krijimit të kushteve të punës dhe kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Pagesat e pagave në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit, si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe monitorimin e vijueshmërisë së rregulltë në punë të punonjësve siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

MKRS gjatë vitit 2022 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 183,968€ në kategori ekonomike joadekuate, si në vijim:

- Pagesa në vlerë prej 29,725€ për kontratën "Furnizimi, montimi dhe konfigurimi i rrjetit LAN në objektin e Bibliotekës Kombëtare" e cila për nga natyra i takon kategorisë investime kapitale ishte paguar/regjistruar në kategorinë mallra dhe shërbime; dhe
- Pagesat në vlerë prej 154,243€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së pagave ishin realizuar nga Thesari (bazuar në vendimin gjyqësor) nga kategoria subvencione dhe transfere (mjete të lira). Borxhi kryesor për këtë pagesë ishte 82,800€ ndërsa shpenzime procedurale dhe kamata ishin 71,443€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimit jo të duhur ekonomik. Po ashtu, është ndikuar nga paditë e bëra në gjykatë për obligimet e MKRS ndaj punonjësve për shkëputjen e kontratave.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë ekonomike jo adekuate ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke mbivlerësuar kategoritë mallra dhe shërbime dhe subvencione, në anën tjetër duke nënvlerësuar kategoritë investime kapitale dhe paga, rrjedhimisht duke ofruar informata të gabuara për lexuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente dhe detyrimeve të papaguara në PFV

Gjetja

Neni 6 i Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, parasheh se "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Shpalosjet e detyrimeve kontigjente dhe detyrimeve të papaguara në PFV ishin të mbivlerësuara. Çështjet e evidentuara janë si në vijim:

- Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 41,016€[6]. Pasi që dy raste ishin prezantuar/përfshirë në listën e detyrimeve kontigjente përkundër që këto lëndë ishin të përfunduara me vendime gjyqësore.

  Ministria nuk kishte listë/evidencë për lëndët që janë në proces, shpalosjen e detyrimeve kontigjente e kishte bërë bazuar në raportin e avokaturës shtetrore i cili nuk ishte i përditësuar.

- Detyrimet e papaguara ishin mbivlerësuar për 16,226€ pasi që ishin

prezantuar/përfshirë në listën e obligimeve edhe 14 avance të pa arsyetuara për udhëtime zyrtare, që nga viti 2010. Të njëjtat ishin prezantuar edhe tek raporti për avancet e pa arsyetuara.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës të ministrisë dhe avokaturës shtetërore si dhe kontrolleve të dobëta në ministri lidhur me evidentimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve të papaguara.

Ndikimi

Prezantimi i avanceve të hapura për udhëtime zyrtare te shpalosja e obligimeve të papaguara dhe shpalosja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka ndikuar në mbi vlerësimin e regjistrave dhe shpalosjen jo të plotë dhe të drejtë të tyre në PVF.

Rekomandimi A1

Ministri përmes zyrtarëve përkatës duhet të sigurojë komunikim efektiv dhe në kohë me avokaturën shtetërore me qëllim të përditësimit të informatave lidhur me detyrimet kontigjente, si dhe të paraqet vlerën e saktë të detyrimeve të papaguara në mënyrë që këto shpalosje të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV-të e vitit 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2004/07 për Shpenzimet e Udhëtimeve Zyrtare, të gjitha avancet duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi.

Në tre raste të testuara avancet e dhëna për udhëtime zyrtare në vlerë 5,999€ nuk ishin mbyllur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar, si në vijim:

- Avanci për udhëtimin zyrtar në Los Angelos, në vlerë 2,955€ ishte i hapur për më shumë se 1 vit (deri në përfundim të auditimit mars 2023 ende ishte i hapur);
- Mbyllja e avancit për udhëtimin zyrtar në Bosnje dhe Hercegovinë në vlerë 2,120€, ishte bërë me 101 ditë vonesë; dhe
- Mbyllja e avancit për udhëtimin zyrtar në Portugali në vlerë 918€, ishte bërë me 97 ditë vonesë.

Për më tepër në Ministri kishte avance të hapura që nga viti 2010 për të cilat zyrtarët përgjegjës ende nuk kishin sjellë dëshmitë përkatëse për mbylljen, përkatësisht arsyetimin e tyre. Vlera e avanceve të paarsyetuara deri në fund të vitit 2022 ishte 47,389€.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve ligjore nga menaxhmenti i Ministrisë ndaj zyrtarëve përfitues për kthimin e mjeteve.

Ndikimi

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve brenda afatit ligjor dhe mos mbyllja e avanceve, rritë rrezikun që paratë publike të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo të keqpërdoren.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuara-avancet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Neni 22 i Rregullës Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, përcakton që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhërblerja dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në 11 mostra të testuara në vlerë 218,452€, kemi vërejtur se në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të procedurave ligjore për

shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të ndikojë që, ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë që ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, e të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhërblerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa dhe dobësi në arsyetimin e subvencioneve

Gjetja

Ministria me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanseve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen sipas marrëveshjeve të nënshkruara kryesisht në fund vit, apo bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara në bazë të afateve të parapara me kontrata.

Në 19[7] raste të testuara (një rast nga viti 2021) në vlerë totale prej 1,784,551€ përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve me kohë, të cilat sipas marrëveshjeve do të duhej të ishin mbyllur. Avancet figurojnë ende të hapura.

Për më tepër, në dy[7] raste tjera ishin vërejtur dobësi në mbylljen e subvencioneve, si në vijim:

- Te mbyllja e subvencionit datë 20.12.2022 ishte pranuar si dëshmi fatura për renovimin e zyrave me vlerë 60,001€ përderisa gjatë ekzaminimit fizik (10.03.2023) kemi vërejtur se nuk ishin pranuar të gjithë artikujt si në faturë. Kjo me arsyetimin (e përfituesit) se fatura ishte paguar në bazë të aneks kontratës si avanc dhe ende ka kohë deri në përfundimin e saj.
- Po ashtu, te mbyllja e subvencionit datë 13.07.2022 ishte pranuar si shpenzim auditimi i projektit me vlerë 1,000€ me dëshminë e vetme të letër angazhimit, me arsyen se do ta sjellë më vonë raportin e auditimit (deri në përfundim të auditimit nuk e kemi pranuar këtë raport).

Kjo ishte si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve si dhe mungesës së mekanizmave adekuat që do t'i kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara.

Ndikimi

Numri i lartë i subvencioneve të pa arsyetuara bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë dhe vlera për para është arritur. Mos arsyetimi dhe raportimi për projektet e subvencionuara, mund të dëmtojnë buxhetin e ministrisë dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Tejkalimi i vlerës së kontratës

Gjetja Neni 2 i kontratës kornizë datë 22.02.2021 thekson "Vlera totale e parashikuar (indikative) e kontratës është 600,000€. Çmimi i ofertës për njësi me TVSH pa peshim është në shumën prej 20,502€. Derivimi i lejuar nga vlera totale e parashikuar (indikative) është plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Te kontrata kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së" në vlerë 600,000€ e nënshkruar më datë 22.01.2021, tejkalimet mbi nivelin e lejuar (mbi +30%) ishin 2.7%, apo shprehur në vlerë monetare 16,235€. Shpenzimet e realizuara gjithsejtë për këtë kontratë ishin 796,235€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve nga menaxheri i kontratës gjatë realizimit të kontratës kornizë.

Ndikimi Monitorimi jo i duhur në menaxhimin e kontratës, duke pranuar shërbime/furnizime ka ndikuar në tejkalim të limiteve të lejuara me kontratë, po ashtu ky tejkalim ndikon në kufizimin e konkurrueshmërisë dhe transparencën lidhur me shpenzimin e fondeve publike.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme duke siguruar që menaxherët e kontratave mbikqyrin realizimin e tyre në plotëni me rregullat përkatëse. Po ashtu, në rastet kur kemi tejkalim të vlerës së kontratës të bëhet shkëputja e tyre sipas dispozitave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B6 - Dobësitë/Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara

Gjetja Neni 39 i Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim. Po ashtu, neni 6 i rregullës financiare nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore, përcakton afatin për dorëzimin e raporteve për obligimet e papaguara prej 15 ditë pas përfundimit të muajit për gjendjen e muajit paraprak. Për më tepër, neni 24, paragrafi 1.3 i rregullores Nr.01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, përcakton se - Të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe evidentohen në librin e faturave.

Lidhur me menaxhimin e obligime të papaguara janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Në 7 mostra në vlerë totale prej 78,451€ kishte vonesa në pagesa nga 63 ditë deri në 3 vite, po ashtu dy prej faturave ishin të pa protokolluara, dhe
- Raportimet mujore në Thesar ishin të mangëta, me vonesë dhe jo konsistente.

Vlen të ceket se për vitin 2022, ministria ka kryer shpenzime në vlerë prej 255,130€ bazuar në vendime gjyqësore/përmbarimore. Prej tyre 167,698€ ishin për borxhin kryesor ndërsa 87,432€ për shpenzimet procedurale dhe kamata.

Vonesat ishin kryesisht të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikimi jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara. Vonesat në raportim dhe mos përfshirja e obligimeve në raportet për obligimet e papaguara ka ndodhur pasi MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit dhe pagesës së faturave, ngase faturat e pranuara nuk protokollohen dhe nuk evidentohen në librin e faturave me kohë.

Ndikimi

Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve, mos protokollimi i faturave me kohë si dhe mos evidentimi i tyre në librin e faturave rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme Ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbarimore të cilat njëherit rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B6

Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat protokollohen, evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit, njëherit edhe raportimi i tyre në Thesar të bëhet i plotë dhe në baza periodike të parapara me rregulla financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 14,685,563€, prej tyre ishin shpenzuar 13,021,111€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja A3 - Dobësi në procesin e thirrjeve publike/vlerësimit të subvencioneve

Gjetja

Neni 17 i rregullores MKRS - Nr. 09/2015 për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit, thekson se "Komisioni për vlerësimin e projekteve duhet të kryej punën e vet brenda afatit prej 15 ditë pune, nga data e mbylljes së konkursit".

Sipas thirrjeve publike, Projekt-Propozimet përfituese duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Procesi i vlerësimit për dy thirrje publike të testuara kishte vonesa, si në vijim:

- Thirrja për fondin e mobilitetit 2022 Sport-Rini-Art-Trashëgimi Kulturore /Individuale afati për aplikim ishte deri më 29.08.2022. Komisioni i vlerësimit kishte bërë vlerësimin me vonesë prej 44 ditëve përtej afatit të lejuar; dhe
- Thirrja për projekt propozimet kulturore 2022 Art dhe Trashëgimi kulturore/Individuale afati për aplikim ishte deri më 22.04.2022. Komisioni i vlerësimit kishte bërë vlerësimin me vonesë prej 144 ditëve përtej afatit të lejuar.

Shkak i vonesave në vlerësim sipas zyrtarëve të ministrisë ishte numri i madh i aplikimeve.

Në dy raste mungonin dëshmitë e kërkuara sipas thirrjes për OJQ:

- Te mostra "Përgaditja e të rinjëve për treg adekuat të punës përmes trajnimeve afatshkurtëra në ekonominë digjitale" e përzgjedhur nga Projekt Propozimi për Rini, në dosje mungonte Certifikata nga Gjykata për OJQ-në që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk është dënuar nga gjykata. Ky kriter do të duhej të plotësohej para nënshkrimit të kontratës; dhe
- Te mostra për pjesëmarrjen e garuesve në kampionatin botëror e përzgjedhur nga thirrja Fondi i Mobilitetit 2022 OJQ/Sport në dosje mungonte dëshmia se OJQ nuk ka obligime tatimore.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve, vonesat në formimin e komisioneve, procesin e vlerësimit si shkak i aplikimit online përmes e-Kosova.

Ndikimi

Vonesat në vlerësim bëjnë të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë janë arritur dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera. Po ashtu, mos përfillja e plotë e kërkesave sipas thirrjes publike mund të rezultojë në përzgjedhje jo të drejtë e të bazuar në kërkesa

ligjore. Dobësitë e identifikuara kanë ndikim në mos zbatimin e projekteve sipas afateve të parapara brenda vitit.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se procesi i vlerësimit të projekteve për subvencionim bëhet në përputhje/brenda afateve kohore të parapara sipas rregullores për subvencionim, dhe në bazë të kritereve të parapara në thirrjet publike me qëllim të zbatimit të projekteve brenda vitit. Po ashtu, të sigurojë që kriteret e vendosura në thirrje publike aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,546,090€, prej tyre ishin shpenzuar 3,784,720€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me renovimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore etj.

Çështja A4 - Dobësi në ekzekutimin e pagesës

Gjetja

Sipas nenit 26.3 të kontratës për Masat preventive - intervenimet emergjente regjioni i Prizrenit (nënshkruar me dt.31.03.2022 në vlerë 337,463€) - Parapagimi, potencon se "Parapagimi do të paguhet duke zbritur shumat proporcionale nga pagesat".

Për situacionet/punët e përfunduara MKRS kishte pranuar dhe paguar dy fatura të plota duke mos aplikuar zbritjen për vlerën e avancit (50,619€) të dhënë më datë 07.07.2022. Njëra faturë ishte në vlerë 78,211€ dt. 18.10.2022 dhe fatura tjetër 45,935€ dt. 15.12.2022.

Kjo ka ndodhë për shkak të mungesës së komunikimit midis zyrës së prokurimit dhe menaxhimit të kontratës.

Ndikimi

Mos aplikimi i zbritjes së avancit në mënyrë proporcionale nga pagesat mund të ndikoj që të përmbyllet kontrata me vlerë më të lartë për vlerën e avancit të dhënë.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës që para përfundimit të kontratës të aplikohet zbritja proporcionale e pagesës së avancit për investime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore në prokurim

Gjetja

Ligji për prokurimin publik 04/L-042, RRUOPP si dhe kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit përcaktojnë dispozitat e përgjithshme në bazë të të cilave bëhet përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues si dhe aktivitetet e menaxhimit të kontratës.

Në testimin e tre (3) procedurave tenderuese kemi hasur mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore, si në vijim:

- Te projekti për intervenime emergjente në Qendrën Kulturore Hebraike në Prizren në vlerë 547,554.34€ mungonte plani i menaxhimiit të kontratës;
- Te projekti për masat preventive-intervenimet emergjente regjioni i Prizrenit në vlerë 337,463€ mungonte plani i menaxhimit të kontratës. Vlerësimi i tenderit ishte zgjatur për më shumë se dy muaj edhe pse është konsideruar si rast emergjent. Për këtë kontratë (e datës 31.03.2022) siguria e ekzekutimit ishte ofruar vetëm për 30 ditë ndërsa kontrata kishte kohëzgjatje 6 muaj, në anën tjetër zotimi i mjeteve nuk mbulon vlerën e kontratës pasi janë

zotuar mjete vetëm 280,000€. Po ashtu, nuk kishte dëshmi që menaxheri i projektit i emëruar nga operatori ekonomik kishte pranuar punët gjatë ekzekutimit; dhe

- Te projekti për intervenime emergjente në Hamamin e Gazi Mehmet Pashës-Prizren, në shtëpinë e familjes Lokvica në Prizren dhe hamamin e qytetit në Mitrovicë, në vlerë 342,899€ (me datë 15.04.2022) mungonte plani për menaxhimin e kontratës, raporti i vlerësimit ishte i nënshkruar nga komisioni mirëpo nuk ishte i plotësuar për përmbushjen e kritereve. Në anën tjetër, zotimi i mjeteve nuk mbulonte vlerën e kontratës pasi janë zotuar vetëm mjete në vlerë 210,000€. Për projektin në fjalë nuk kishte dëshmi për zhvillim të negociatave.

Kjo ka ndodh për shkak të kontrolleve të dobëta gjatë gjithë procedurave/proceseve për këto aktivitete duke u arsyetuar se këto ishin raste emergjente.

Ndikimi

Mungesa e sigurisë së ekzekutimit rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale. Përzgjedhja e OE fitues që nuk përmbush kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, rezulton me shpërblimin e OE në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës në procese të tenderimit të kërkojë zbatim të plotë të procedurave dhe kërkesave për çdo kontratë publike të nënshkruar bazuar në kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesat në realizimin e punimeve

Gjetja

Nenet 61.6, 61.19 dhe 61.20 të Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit. Po ashtu, bazuar në dispozitat e marrveshjeve të bashkëpunimit me komunat përkatëse, përcaktohet që: MKRS në bashkëpunim me komunat përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit.

Në gjashtë (6) raste, kemi identifikuar që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, prej tyre tre raste ishin projekte bashkëfinancim me komunat. Rastet e identifikuara si dhe ditët e vonesave janë llogaritur sipas kontratës/projektit deri në dhjetor 2022, si në vijim:

- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Lipjanit me datë 31.03.2020 për bashkëfinancim të projektit. Komuna kishte nënshkruar kontratë për projektin “Ndërtimi i palestrës sportive Lipjan” me datë 07.10.2019 në vlerë 1,748,298€. Sipas pikës 17.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK), afati për kryerjen e punëve ishte deri më 31.12.2021. Përderisa, sipas

nenit 3.1 të memorandumit obligimet e ministrisë, përveq investimit në vlerë 700,000€, ishin që të caktoj projekt menaxherin për monitorimin e kontratës dhe së bashku me komunën të kujdesen për implementimin e projektit. Vonesat në përfundimin e këtij projekti ishin 12 muaj. Deri në kohën e përfundimit të auditimit ky projekt ende nuk kishte përfunduar.

Sipas menaxherit të projektit të ministrisë shkak për këto vonesa ishte situata pandemike e krijuar në vitin 2020/21;

- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Ferizajit me datë 07.08.2018 për bashkëfinancim të projektit. Komuna kishte nënshkruar kontratë për projektin "Ndërtimi i Sallës Sportive Greme Ferizaj" me datë 08.08.2018 në vlerë 1,195,727€. Sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) pika 10.2 afati për kryerjen e punëve ishte deri më 08.08.2021. Përderisa, sipas nenit 3.1 të memorandumit obligimet e ministrisë, përveq investimit në vlerë 1,200,000€, ishin që të caktoj projekt menaxherin për monitorimin e kontratës dhe së bashku me komunën të kujdesen për implementimin e projektit. Vonesat në përfundimin e këtij projekti ishin 16 muaj. Deri në kohën e përfundimit të auditimit ky projekt ende nuk kishte përfunduar.

  Sipas menaxherit të projektit të ministrisë shkak për këto vonesa ishte situata pandemike e krijuar në vitin 2020/21;

- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Gjakovës me datë 30.05.2017 për bashkëfinancim të projektit. Komuna kishte nënshkruar kontratë për projektin "Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rugovë të Hasit në Komunën e Gjakovës" me datë 22.02.2018 në vlerë 999,210€. Sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) afati për kryerjen e punëve ishte 30 muaj. Përderisa, sipas memorandumit obligimi financiar i komunës ndaj këtij projekti ishin vetëm 10,000€, pjesën tjetër të obligimeve do ti mbuloj ministria. Krahas këtij financimi obligim i ministrisë ishte që të caktoj projekt menaxherin për monitorimin e kontratës dhe së bashku me komunën të kujdesen për implementimin e projektit. Vonesat në përfundimin e këtij projekti ishin 28 muaj. Deri në kohën e përfundimit të auditimit ky projekt ende nuk kishte përfunduar.

  Sipas menaxherit të projektit shkak për këto vonesa ishte situata pandemike e krijuar në vitin 2020/21;

- MKRS kishte nënshkruar kontratë për projektin "Masat Preventive-Intervenimet Emergjente Regjioni i Prizrenit" më datë 31.03.2022 në vlerë 337,463€. Sipas KVK, pika 9 afati për kryerjen e punëve ishte 6 muaj. Vonesat në realizimin e punimeve ishin 2 muaj. Deri në kohën e ekzaminimit fizik (mars 2023) ky projekt ende nuk kishte përfunduar.

  Sipas menaxherit të kontratës arsyet e vonsave janë pengesat nga bashkëpronarët duke refuzuar ndërhyrjen në këto ndërtesa;

- MKRS kishte lidhur kontratë për projektin "Ndërtimi i Qendrës së Edukimit Joformal në Pjetershan" më datë 08.07.2019 në vlerë 173,709€. Sipas KVK, pika 17.2 afati për kryerjen e punëve është 5 muaj. Vonesat në realizimin e punimeve deri në pranimi teknik më

23.12.2022 ishin 36 muaj.

Sipas menaxherit të kontratës shkak për këto vonesa ishin situate pandemike e krijuar në vitin 2020/21 dhe punët shtesë të paparashikuara; dhe

- MKRS kishte nënshkruar kontratë për projektin "Intervenimet emergjente në rajonin e Prizrenit" më datë 29.12.2021 në vlerë 119,477€. Sipas KVK pika 9 afati për kryerjen e punëve ishte 6 muaj. Punët kishin përfunduar me 5 muaj vonesë sipas raportit nga menaxheri i kontratës, përderisa nuk kemi pranuar raport të pranimit teknik.

  Sipas menaxherit të kontratës arsyet e vonesave janë kushtet atmosferike si dhe zgjatja e procedurave për aprovimin e punëve shtesë.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore në vitet vijuese, po ashtu ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara të ministrisë.

Rekomandimi B7 Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 56,451,658€ pasurive jokapitale 258,399€ si dhe e stoqeve 15,888€.

Çështja B8 - Mangësi në inventarizimin e pasurive dhe caktimin e komisioneve

Gjetja

Neni 19 i rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore, përcakton formimin e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive dhe ndër të tjera thekson përgjegjësinë për hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Ministria nuk kishte themeluar komisionet për inventarizim dhe për vlerësimin e pasurive për vitin 2022. Përderisa, Biblioteka kishte hartuar raporte individuale të cilat nuk ishin harmonizuar në një raport përmbledhës dhe se ASHAK ka dorëzuar një raport të inventarizimit i cili ishte i mangët pasi përmbante vetëm përshkrim mirëpo jo edhe të dhënat sipas kërkesave të rregullores.

Ministria nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për ndarje të drejtë të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasuritë e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit. Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të ministrisë sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi

Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi B8

Ministri duhet të sigurojë se themelohen komisionet përkatëse dhe bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, ZKA duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë për shkak të numrit të lartë të insitucioneve vartëse në kuadër të MKRS.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në sistemet e menaxhimit të pasurisë

Gjetja

Neni 6.3 i rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, potencon” Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Ministria nuk kishte zbatuar në tërësi kërkesën për mbajtjen e regjistrit kontabël në sistemin e-pasuria. Sistemi nuk përdoret në njësitë vartëse të ministrisë, në Bibliotekën Kombëtare dhe në ASHAK (ku nga viti 2020 nuk kishte zyrtar të pasurisë).

Përderisa mostrat e testuara në regjistrin kontabël të SIMFK-së në vlerë 269,653€ (të cilat kryesisht ishin bashkëfinancim me komuna) nga viti 2015 figurojnë si investime në vijim. Për këto projekte nuk kemi pranuar informata për pranimin teknik të tyre [9].

Krahas kësaj, vlen të theksohet se në regjistrin kontabël ende figurojnë shtatë (7) vetura me vlerë zero të cilat janë të shitura nga Ministria e Administratës Publike (MAP) me datë 09.06.2021, me kërkesë të MKRS.

Kjo ishte për shkak të dobësive në funksionim të kontrolleve të brendshme sa i përket largimit të veturave nge regjistri i ministrisë si dhe mungesës së zyrtarit për pasuri dhe trajnimeve për zyrtarët e njësive vartëse.

Ndikimi

Mos funksionimi i sistemit për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon ministria, si dhe mund të rezultojë në humbjen e tyre. Po ashtu, mos azhurnimi i regjistrave jep informata jo të sakta për pasuritë e ministrisë.

Rekomandimi A6

Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, që njësitë vartëse të kompletojnë pozitat me zyrtarë të pasurisë dhe të njëjtit të trajnohen për përdorimin e sistemit e-pasuria. Po ashtu, në bashkëpunim me komunat duhet ndërmarrë veprime për të siguruar informatat e plota mbi pranimet teknike me qëllim që të azhurnohen regjistrat e SIMFK, përderisa pasuritë e shitura të MKRS në bashkëpunim me MFPT të largohen nga regjistrat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një anëtar-Drejtori i NjAB-së. NjAB përveç planit strategjik kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2022 dhe deri në fund të vitit kishte realizuar në tërësi planin e auditimit. NJAB kishte realizuar gjithsej pesë (5) auditime sipas planit vjetor të punës për 2022. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 21, prej të cilave të zbatuara ishin dy (2), në proces ishin nëntë (9) dhe të pazbatuara ishin dhjetë (10). Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të MKRS-së. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB.

Çështja A7 - Mos kompletimi i NjAB

Gjetja

Rregullorja 01/2019 për Themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) neni 5.1.1, përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.

NJAB nga muaji mars 2022 funksionon vetëm me drejtorin e NJAB-së, për shkak të pensionimit të një auditori. Në planin e rekrutimit ishte paraparë procedura për rekrutim/plotësim të pozitës, megjithatë konkursi (për një pozitë) ka dështuar si pasojë e mungesës së kandidatëve adekuat.

NJAB përkundër që kishte arritur të përmbush planin vjetor të auditimit, ky plan nuk ishte gjithë përfshirës duke marrë parasysh që MKRS ka shumë njësi vartëse dhe përfshirja e tyre në auditim është e një rëndësie të veqantë për menaxhmentin.

Ndikimi

Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi A7

Ministri duhet të sigurojë që NJAB plotësohet me staf të mjaftueshëm, në mënyrë që në plan të auditimit të përfshihen një numër më i madhë i auditimit të njësive vartëse të ministrisë si dhe të aktiviteteve të ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[10]	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**39,159,108**	**34,633,167**	**25,103,236**	**32,632,436**	**25,583,740**
Grante Qeveritare – Buxheti	39,094,718	34,302,821	24,930,327	32,532,239	23,555,254
Të bartura nga viti i kaluar	0	17,245	10,456	9,148	15,373
Të hyrat vetanake	64,390	64,390	6,065	8,091	10,378
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	1,988,892
Donacionet vendore	0	13,898	0	0	509
Donacionet e jashtme	0	234,813	156,388	82,958	13,333

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 4,525,940€. Kjo ulje është si rezultat kryesisht i vendimeve të qeverisë për kursime buxhetore për shkak të projekteve të pa përfunduara kapitale (ulja e buxhetit te Investimet Kapitale ishte 11,163,910€).

Në vitin 2022 MKRS ka shpenzuar 72% të buxhetit përfundimtar ose 25,103,235€, me një ulje prej 20% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel jo të kënaqshëm sidomos te Investimet Kapitale (rreth 40%) dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**39,159,108**	**34,633,167**	**25,103,236**	**32,632,436**	**25,583,740**
Pagat dhe mëditjet	5,306,571	5,384,487	4,880,533	4,968,085	5,074,725
Mallrat dhe shërbimet	2,521,079	4,592,094	3,152,252	2,818,240	1,571,340
Komunalitë	404,908	424,933	264,618	278,081	240,436
Subvencionet dhe transferet	10,216,550	14,685,563	13,021,111	15,439,950	11,157,716
Investimet Kapitale	20,710,000	9,546,090	3,784,720	9,128,081	7,539,522

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 77,916€, nga grantet e donatorëve. Shpenzimet ishin 91% e buxhetit;

Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 2,071,015€. Rritja ishte ndikuar nga ndarjet për Pakon e Ringjalljes Ekonomike 75,000€ për mbështetjen e kulturës dhe sportit, të hyrat vetanake 17,245€, Grantet e Përcaktuara të Donatorëve në vlerë 121,770€, si dhe me vendime të Qeverisë vlerë 1,857,000€. Buxheti në këtë kategori ishin shpenzuar 69%;


Buxheti final i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 20,000€ me vendime të Qeverisë për ndarje buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 62% e buxhetit;

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,469,013€. Rritja ishte si rezultat i ndarjeve nga Pako e Ringjalljes Ekonomike 880,725€ për mbështetje financiare për projekte të caktuara si filmi Zgjoi dhe Manifesta 14 - Prishtina 2022, granteve të përcaktuara të donatorëve 49,000€ si dhe Vendime të Qeverisë 3,539,288€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 89%;

Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 11,163,910€. Ulja e buxhetit ishte ndikuar nga vendimet e qeverisë për kursime buxhetore si pasojë e mos realizimit të projekteve kapitale. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 40%; Nga 111 projekte të planifikuara me buxhet fillestar vlerë 20,710,000€, për 29 prej tyre nuk kishin filluar fare procedurat e prokurimit. Ndërsa me buxhet final ishin paraparë 106 projekte me vlerë 9,546,090€, për 53 projekte prej tyre në vlerë 2,305,000€ nuk kishin filluar procedurat e prokurimit me arsyetimin se nuk ka pas kërkesë nga njësit kërkuese për fillimin e procedurave.

Nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike ishin ndarë mjete në vlerë 795,754 për Masën 4.3 Mbështetja e kulturës dhe sportit për vitin 2022. Prej tyre, nga kategoria e mallra dhe shërbimeve ishin shpenzuar 29,998€, ndërsa nga subvencionet dhe transferet 766,086€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2022 ishin në vlerë 139,703€. Këto të hyra janë realizuar kryesisht nga: taksat administrative, participimet, të hyrat nga kinematografia, të hyrat nga qiraja publike, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale dhe të hyrat nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	**281,338**	**281,338**	**139,703**	**58,412**	**27,680**
Të hyrat jo tatimore	281,338	281,338	54,077	37,125	27,205
Të hyrat tjera	0	0	85,625	21,287	475

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të MKRS ka rezultuar në 14 rekomandime. MKRS nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku do të paraqitej mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte në proces dhe tetë (8) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.	Edhe për vitin 2022 kemi raste të mbivlerësimit të pasurive.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Ministria kishte ndërmarrë disa masa (Shih çështjen C1)	Pjesërisht i zbatuar
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi

		sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.		
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se janë trajtuar të gjitha kërkesat për lidhjen e kësaj kontrate si dhe mosshfrytëzimit të saj, po ashtu, të trajtojë shkaqet e mos ndërmarrjes me kohë të veprimeve nga zyrtarët kompetent për shkëputjen e kontratës. Më tutje, të ndërmarrë veprimet e nevojshme konform kërkesave ligjore në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten rastet e tilla.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme në vitin 2022.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avanset për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, të ushtrojë padi gjyqësore kundër të gjithë zyrtarëve të cilët nuk kanë arsyetuar shpenzimet e udhëtimit zyrtar.	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit.	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të prokurimit me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera (njësitë kërkuese) për të diskutuar kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri, në mënyrë që vetëm kërkesat e arsyeshme të njëjta apo të ngjashme mblidhen në një	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme në vitin 2022	I zbatuar

		aktivitet të prokurimit për të fituar vlerën për paranë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.		
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë aplikimin e procedurave adekuate të prokurimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve, dhe njëherësh të sigurohet që në rastet kur përdoret procedura e negociuar të sigurohen dëshmitë përkatëse që mbështesin përdorimin e një procedure të tillë.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme në vitin 2022.	I zbatuar
11.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që komisionet e vlerësimit i përmbahen kërkesave të legjislacionit përkatës me rastin e vlerësimit të aplikacioneve si dhe të bëj hartimin e një dokumenti të brendshëm i cili qartëson procedurën e vlerësimit të projekteve (poentimin) pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni për rastet të cilat i kanë plotësuar kriteret për thirrje publike.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme në vitin 2022.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e formimit të komisioneve të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave në mënyrë që zyrtarët të cilët përgatitin specifikimet të mos caktohen në komisionet e vlerësimit.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme në vitin 2022.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	Ministri duhet të bëj një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave, si dhe të rishikoj disponueshmërinë e fondeve kundrejt punimeve të kontraktuara. Në të kundërtën, nuk duhet të nënshkruhen kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve.	Edhe në vitin 2022 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.	Edhe këtë vit janë evidentuar mangësi në inventarizimin e pasurive.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ajtene Llapashtica, Udhëheqëse e ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Ardita Haxhiaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	**Komenti i OB-së**	**Pikëpamja e ZKA-së**
A2 - Tejkalimi i vlerës së kontratës	MKRS nuk pajtohet me të gjeturën A2. Tejkalim i vlerës së kontratës kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së" për 16,235€; Koment: lidhur me këtë çështje Zyrës Kombëtare të Auditimit ju është paraqitur dy dokurnente të cilat faktohen se nuk ka ndodhur asnjë shkelje e vetme e Ligjit të Prokurimit Publik e as e rregullave tjera në fuqi, ekziston një Opinion i KRPP-së ku thekson qartë se të procedurat e karakterit (me çmim njësi) vlera financiare tavan nuk vlen. Po ashtu edhe një ekspertizë e veçantë nga Eksperti i Prokurimit i cili është konsulent i angazhuar nga Ambasada Britanike dhe Projekti DAI në Ministrinë e Kulturës. Konkretisht këto dy opinione edhe nga KRPP edhe nga Eksperti i DAI-t dhe Ambasadës Britanike mbështesin se aspekti i tejkalimit të vlerës financiare është e rregulluar me RrOUPP (rregullat në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës) dhe gjejnë zbatim: në Nenin 56, paragrafi 5 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik sa i përket kontratave për shërbime të shumëfishta ose kontratave me çmime për njësi përcakton si në vijim: "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve"ose secilit " artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtie te gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime të raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund te udhëhiqen për te gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe pune". Bazuar në fjalinë e dytë e këtij Neni ku ceket: Ne	ZKA nuk i konteston interpretimet e KRPP-së dhe ekspertit sa i përket procedurave bazuar në nenin 56.15 të RrUOPP për procedurën lidhur me kontratën çmim për njësi. E gjetura e trajtuar në këtë raport ka të bëj konkretisht me nenin 2 të kontratës të nënshkruar mes OE dhe AK e cila e kufizon tejkalimin e kësaj kontrate +/- 30%. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

	këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtje te gjeneratorëve etj, përcakton shume qarte dhe konkret se AK, sipas nevojës për këto shërbime mund te bene porosi por edhe te pranoi shërbime apo mallra nën përqindjen prej 30%, apo mbi përqindjen prej 30% sipas nevojave dhe kërkesave te njësive kërkuese për shërbime të tilla në kuadër te MKRS. Nga te gjitha arsyetimet dhe konstatimet e cekura me larte mund te arrihet deri te përfundimi se AK - MKRS, ne kontratën ne fjale nuk ka bere asnjë shkelje ligjore, si dhe veprime qe bien ne kundërshtim me asnjë dispozite te Legjislacionit te Prokurimit Publik, por ne kuadër te kushteve dhe situatave te krijuara gjate zbatimit te kësaj kontrate ka vepruar me përpikëri me te gjitha kërkesat e Legjislacionit te Prokurimit Publik ne Kosovë	

29. 06. 2023
03 47 1088 2

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Nr. 3318/2023
Data 29.06.2023
PRISHTINË/PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –Ministry of Culture, Youth & Sport

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Tema: Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe zbatimin e rekomandimeve

27 qershor 2023

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet, përveç me të gjeturën A2: Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së për 16. 235 €, për të cilën pikë ju kemi bashkëlidhur komentin në këtë dokument konfirmimi
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Hajrulla Çeku, Ministër

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[11] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[12], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Renovimi i stadiumit të qytetit Prishtinë-pranimi teknik i vitit 2019 në vlerë 3,843,715€; 2. Renovimi i stadiumit të qytetit Kamenicë-pranimi teknik i vitit 2019 në vlerë të memorandumit 184,000€, pasi në pranim teknik nuk ka vlerë; 3. Palestra sportive në Skenderaj-pranimi teknik i vitit 2021 në vlerë 164,837€; 4. Palestra sportive Deçan-pranimi teknik i vitit 2016 në vlerë 1,658,658€; 5. Renovimi i stadiumeve qendra regjionale-pranimi teknik I vitit 2016 në vlerë 25,991€; 6. Palestra sportive Dardanë II-pranimi teknik I vitit 2019 në vlerë 41,977€; 7. Arkivi I qytetit Shtime-pranimi teknik I vitit 2019 kontrata në vlerë 163,940€, nuk ka info në cilën vlerë u shkëput kontrata; 8. Qendra Kulturore –Rinore në Han të Elezit-pranimi teknik I vitit 2022 në vlerë 267,552€; 9. Ndërtimi I qendrës së edukimit jo formal Rini Pjetershan-pranimi teknik 2022 në vlerë 191,049€.

[6] Detyrimi Kontigjent i paraqitur me vlerë 17,736€, Kjo lëndë gjyqësore është e përfunduar dhe gjykata ka vendosur sipas padisë deri në instancën e fundit në shkallën e tretë si Gjykata Supreme e Kosovës të datës 04.08.2022. Detyrimi Kontigjent i paraqitur me vlerë 23,280€, është realizuar nga Thesari me urdhër përmbarimi me datë 24.11.2008 me shpenzim nga Thesari.

[7] Avance të hapura sipas departamenteve SPORT 11, KULTURA 7 dhe QKK 1 mostër.

[8] SPORT - Komiteti Olimpik i Kosovës, pagesa 170,000€/renovimi i zyrave 60,000€ dhe QKK - Përfituesi Tilia Entartainment SHPK, pagesa 15,000€/Projekti I love you more/ shpenzimet e auditimit 1,000€.

[9] Projekte që figurojnë pagesa të regjistruara si investim në vijim pa informata: 1. Stadiumi Përparim Thaqi Prizren me kontratë 1,574,537€ e vitit 2017; 2. Ndërtimi I Palestrës së Sportit në Zahaq të Pejës me kontratë 1,018,805€ e vitit 2017; 3. Ndërtimi I Qendrës së Kulturës në Vushtrri me kontratë 1,178,132€ e vitit 2015; 4. Stadiumi ndihmës në Prizren me kontratë 339,468€ e vitit 2017; 5. Masat preventive intervenime emergjente me transfer 9,743€ e vitit 2015; 6. Ndërtimi I shtëpisë së kulturës Ukë Bytyçi-Suharekë me kontratë 747,891€ e vitit 2020; 7. Palestra sportive Burim me kontratë 1,275,448€ e vitit 2010; 8. Renovimi I stadiumit të futbollit Suharekë me kontratë 103,851€ e vitit 2020 dhe.9.Bashkfinancim për ndërtimin e bazenit olimpik në vlerë të projektit 660,000€. .

[10] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[11] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[12] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.